



Viti i dhjetë i botimit, Mujore, Nr.12 (128) Dhjetor 2009
 gazetamokra@yahoo.com Kryeredaktor: FLORI SLATINA
 www.pogradeci.com/mokra

ÇMIMI 20 LEKE

10 vjet shoqata mokrare "Pelioni"

Me emrin e qytezës ilire "Pelioni", e cila gjendet në zemrën e Mokrës, vendosën ta quajnë shoqatën e tyre një grup intelektualësh nga kjo zonë. Mundësitë për të zbuluar diçka të re për Mokrën janë të shumta. Ajo është një labirint që, nga do të kthehesh, të del para një dhomëz e pa eksploruar. Dashuria për vendlindjen, është shumë e theksuar për mokrarët, prandaj edhe interesi për formimin e kësaj shoqate këtu e ka burimin.

Përpjekjet për krijimin e saj e kanë filluesën shumë më herët, që nga viti 1996, por pengesat objektive dhe subjektive bënë që zyrtarisht ajo të legalizohej në dhjetor të vitit 1999, që do të thotë 10 vjet aktivitet intensiv i saj.

Janë pikërisht bijtë e kësaj zone, Haki Balliu, Flori Slatina (Balliu), prof. Isa Gorica, prof. Pasko Vako, Dylber Mani, Llazi Tona, Bajram Balla, Astrit Rapçe etj, at që këmbëngulën deri në realizimin e këtij objekti. Qëllimi i së cilës ishte dhe mbetet që, nëpërmjet gazetës së vet "Mokra", të hedhë dritë mbi ato vlera të pashtershme që mbart kjo zonë. Për realizimin e këtij objekti, kryesia e shoqatës, që me krijimin e saj, u bëri thirrje të gjithë



Ndodhet në Qarkun e Korçës. Përfshin: Qytetin e Pogradec dhe 7 Komuna, Trebinjë, Çërravë, Dardhas, Velçan, Porptisht, Buçimas, Udënisht



Gorarët mblidhen në Pogradec për festat e 28 Nëntorit

Nga Istref HAXHILLARI

Rrodokali jeton thjesht e bukur!

VAJZA DHE NIPI NGA PELIONI, DREJTUAN EPIRIN PAS VDEKJES SË PIRROS

Nga Zenun FERRO

Një grup kalorësish, përkrahës të Ajakidit, dy prej tyre Angeli dhe Androkli-di, morën Pirron e vogël dy vjeçar të mbështjellë. Pas tre ditësh e dërguan në pallatin e mbretit të taulantëve, Glaukut. Të dy motrat e Pirros, Deidamea e Troa

Njohuri për nënprefekturën e Pogradecit

PËRSHTYPJE NGA STAMBOLLI

Nga Haki BALLIU

Në këtë mesvjeshte me ngrohtësi pranvere, ndodhi të udhëtoja për në Stamboll. Befasia e parë ishin stjuardesat tek dera e avionit. Jo thjeshtë për bukurinë që kishin, por për dyfjalëshin me të cilën na përshëndetën:
 - Bujurun efendëm !



Redaksia e gazetës "Mokra" dhe kryesia e shoqatës "Pelioni" urojnë të gjithë mokrarët, kudo ndodhen, "Gëzuar Vitin e Ri 2010!"

Gorarrët mblidhen në Pogradec për festat e 28 Nëntorit

Nga Istref HAXHILLARI

Historia është lëndë inkadesh ente e tejetëshme, materje flude përvëluese prej së cilës njerëzimi nuk mund të shkëputet kurrë. E tashmja, po sidomos e ardhmja nuk mund të kuptohen apo spjegohen jashtë historisë, ndaj gjithkushë kthejmë kokën pas dhe vështrime të magjepsur në motmotshmërinë e thinjur. E tillë është historia: - rrënjë, krenari, pendim, këshillë për të cilën kemi nevojë gjithëmonë.

Një rastësi e pakuptuar, apo ndoshta Shkrimi i Shenjtë, parathënës i fatit të njerëzve dhe kombeve, e ka lidhur historinë e dheut tonë me muajin Nëntor. Ngjarjet kulmore të historisë sonë të vjetër e të re, ngjarje që kanë përcaktuar kahun e rrjedhës së zhvillimit të vendit i kanë rrënjët e tyre nëpër nëntorët e moteve të shkuar.

Ishte nëntori i vitit të largët 1443, kur Skënderbeu hyri në Krujë dhe shpalli luftën kundër turkut, pastaj bashkimin e trojeve shqiptare në një shtet të vetëm. Përgjatë një çerek shekulli Shqipëria u bë epiqendra e zhvillimeve europiane, graviteti i shenjtë i mbrojtjes së krishtërit nga invazionet e hordhive të pafundme aziatike, shembëlltore e progresit dhe ardhmërisë.

Nëntori i dytë, në motin 1912, shpalli mëvetësinë e Shqipërisë pas robërisë stërgjatë otomane dhe e futi kombin tonë në radhën e vendeve të tjera europiane. Tashmë njihen sakrificat e panumërta të mëmëdhetarëve për të arritur pavarsinë e bekuar, nisma e Ismail Qemalit dhe bashkëpunëtorëve të tij për ngritjen e flamurit në Vlorë e atij viti, ndaj nderimit për ta është i përhershëm dhe i pavdekshëm.

Nëntori i tretë i vitit 1944 çliroi vendin nga pushtuesit fashistë dhe e renditi Shqipërinë krahas kombeve të tjera të koalicionit antinazist. Lufta e dytë botërore ishte një parapsllje gjigande njerëzish dhe armatimesh nga më modernet e kohës, me miliona viktima dhe shkatërrime të pashembullta në historinë e planetit. Shqipëria e vogël mbajti të gozhdura forca të konsiderueshme të Boshtit luftënxitës, dha mijëra dëshmorë dhe e fitoi lirinë me gjak e sakrificat të panumërta.

Në përkujtim të këtyre ngjarjeve të mëdha historike, Shoqata Atdhetare Kulturore GORA, Dega e Pogradecit, organizoi një drekë festive në mjediset e lokalitë simpatik "Natyra e qetë", buzë liqenit. Merrnin pjesë mbi 200 burra e gra, djem e vajza gorare, pleq të moçëm dhe fëmijë fare të vegjël. Të gjithë të gëzuar, të gjithë me një ngarkesë emocionale të dukshme. Këngëtarët e njohur gorarë, Marjeta Balliu, Hasan Ruho, Gëzim Mazelli e sa e sa të tjerë vinin të sillnin folkun e famshëm gorar, me repertor të zgjedhur për nëntorët e Shqipërisë.

I ftuar në këtë takim solemn, kryetari i SHKA "GORA", z. Besim Shyti. Me pamje fisnike, sy të ndritshëm të aftë të zhbijojnë shpirtin e njeriut, autor i librave me vlera të larta historike për gorarët e mençur e trima nëpër mote të shkuara, Besim Shyti është tashmë një personalitet i letrave gorare e më gjërë. Tek e vështron këtë burrë me shtat të drejtë si qiri, të mirë dhe të dhembshur, ndjen dëshirën e vetvetishme ta përqafosh për të marrë pak mirësi që e ka me bollëk dhe pa kursim për cilindo.



Pamje nga festimet e 28 nëntorit në Pogradec. Në qendër kryetari i shoqatës "Pelioni", Pëllumb Zade, përshëndet gorarët me rastin e festave

Tetëdhjetë vitet e moshës sikur i kanë kaluar tangent për ta lënë të ri gjithnjë këtë njeri të rrallë.

Në krah të tij kryetari i shoqatës "MOKRA", z. Pëllumb Zade, dinjitoz dhe i pashëm si gjithë mokrarrët.

Takimin e hapi kryetari i Shoqatës GORA për rrethin e Pogradecit, z. Eqrem Pllloha.

- Si çdo vit, - tha ai, - ne mblidhemi të përkujtojmë nëntorët e atdheut tonë, festat e mëdha historike. Nëntorët e moteve të shkuara kanë bërë historinë e Shqipërisë. Ne përkujtojmë sot dëshmorët që shkruan epopenë e lavdishme të atyre viteve me gjakun e derdhur pa kursim në altarin e atdheut.

Pasi prezantoi të ftuarit e takimit, z. Pllloha ia dha fjalën Kimet Ismailit, kryetar i Shoqatës për qytetin e Pogradecit. Z. Kimet bëri një ekspozitë të veprimtarisë së shoqatës duke e vënë theksin në vazhdimësinë e veprimtarive kulturore, kalimin e traditës tek brezi më i ri.

U prit me duartrokitje fjalë e kryetarit të shoqatës, z. Besim Shyti.

- Më gëzohet zemra, - nënvizoi ai, - që ju shoh të bashkuar, të gëzuar dhe të qeshur. Historia e Gorës si e gjithë Shqipërisë është shkruar me gjak dhe sakrificat të panumërta, ndaj e kemi obligim t'i nderojmë përgjithnjë, vit pas viti. E rëndësishme është prania e të rinjve në këtë festë të bukur, atyre që do të çojnë përpara traditën, atyre që do t'u përcjellin brezave të nesërmë Shoqatën tonë të mrekullueshme. Unë ndihem komod në gjrin tuaj se më mbetet pak për të bërë. Ju e dini po aq mirë sa mua rëndësinë e takimeve të tilla, ju e kuptoni edhe më mirë forcën e bashkimit tonë kudo që jemi. Shoqata është shtrirë sot kudo ku jetojnë dhe punojnë shqiptarët jo vetëm brenda trojeve të atdheut por edhe jashtë tij gjer në Amerikën dhe Kandanë e largët. Rua-

jtja e traditave, zakoneve dhe kulturës sonë është detyrë e madhe që pasardhësit të mos e harrojnë kurrë identitetin shqiptar, ashtu si kanë bërë arbëreshët e Italisë, ashtu si kanë bërë shqiptarët e Amerikës dhe viseve të tjera ku janë mbartur nëpër motet e shkuara.

Mezet dhe vera, kënga e traditës dhe urimet, vallet e luajtura me mjeshtëri nga të rinjtë shoqëruan më tej festën.

Kryetari i Shoqatës Pelioni (MOKRA), z. Pëllumb Zade, në fjalën përshëndetse tha:

- Duke i dhënë këtij takimi rëndësinë që meriton, unë isha përgatitur të flisja me shkrim, por e shoh se ato fjalë nuk mjaftojnë. Gora dhe Mokra në shekuj kanë qenë bashkë dhe kanë përcjellë po bashkë ngjarjet më të mëdha të historisë së Shqipërisë. Në qershor të vitit 1912, çetat e përbashkëta të dy krahinave, të mbledhura në Podgozhan të Mokrës nën udhëheqjen e Kajo Babjenit çlijuan Pogradecin dhe tërë rrethin nga fotcat shoviniste serbe dhe grake duke shpallur pavarësinë e trevave tona katër muaj përpara se Ismail Qemali të ngrinte në Vlorë fla-

murin e pavarësisë së atdheut. Të dy Krahina kanë zakone të njëjta dhe tradita të përbashkëta. Besa dhe burrëria, mikpritja dhe trimëria kanë qenë njëllot të pranishme si në Mokër dhe në Gorë.

Në fund të kësaj ditë përkujtimore të gëzuar u ndanë fletë nderi dhe mirënjohje të tjera për biznesmenin e njohur gorar Fidai Hoxhallari, i ndarë para pak kohës nga jeta, themeluesin e degës së Shoqatës GORA për Pogradecin, Hysni Rrokori, ish oficerin e lartë dhe burrin e nderuar të Pogradecit, z. Nazar Berberi etj

Sa herë vjen nëntori, ne mokrarrë dhe gorarë kujtojmë me respekt historinë, gjakun e të parëve tanë, heroizmin dhe trimërinë, bëmat e panumërta përgjatë kohës së shkuar. Kur vjen nëntori, ne shqiptarët duket sikur festojmë një ditëlindje të madhe që nuk harrojmë kurrë ta kremtojmë, pa çka se jo gjithnjë në një mendje me njëri - tjetrin. Sa herë vjen nëntori ne festojmë ditëlindjen e madhe të atdheut tonë, që ashtu si zogu Feniks, është gjakosur, është djegur, po ka rilindur sërish nga hiri i vet.

INAGUROHET RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS SË FSHATIT LIN

Gjatë vizitës që bëri më datën 27 nëntor 2009 në Pogradec, Kryeministri Sali Berisha, inaguroi edhe rikonstrukcionin e rrugës së fshatit Lin. Kjo rrugë me gjatësi 1.8 kilometra, gjersëi 8 metra dhe tortuarre në të gjithë gjatësinë e saj ka një vlerë prej 36 milion lekësh dhe përmban të gjithë elementët e një rruge moderne dhe bashkëkohore. Duke përshëndetur banorët e pranishëm, Kryeministri Berisha i siguroi ata se qeveria do bëjë çdo investim që LINI TURISTIK të rimëkëmbet gjithnjë e më shumë. "Shpreh kënaqësinë për këtë ditë që ne inagurojmë këtë rrugë kaq të bukur, një bulevard të vërtetë, në një prej fshatarëve më piktoreskë të Shqipërisë, në fshatin Lin. Gjithëçka ka ndërtuar dhe ndërtun njeriu, gjithëçka të mirë e realizon për vete, për fëmijët, për familjen, për shoqërinë, e ka të bazuar në djersënnë sakrificën e tij, -tha zoti Berisha. Kryeministri siguroi kryetarin e Komunës dhe gjithë banorët e Linit se qeveria do të bëjë çdo investim turistik, që Lini turistik të rimëkëmbet gjithnjë e sa më shumë. **Zabit CUKU**

Urë Lidhëse

Në këtë mesvjeshte me ngrohtësi pranvere, ndodhi të udhëtoja për në Stamboll. Befasia e parë ishin stjuardesat tek dera e avionit. Jo thjeshtë për bukurinë që kishin, por për dyfjalëshin me të cilën na përshëndetën:

- Bujurun efendëm!

Për një çast e folura e tyre disi e përtypur, m'u duk si e vjedhur nga fondi i gjuhës shqipe nëpër netët e gjata pa hënë. Në atë fillim udhëtimi megjithëse admiroja pak, më duhej të përshatesha shumë, sepse më stërmundonte një hall i madh. Së bashku me time shoqe shkonim në Stamboll, me shpresën e bardhë që ajo të rifitonte dritën e humbur të syve, nëpërmjet transplantit. "Të paktën të më shpëtojë njëri. Me një sy shikon gjithë botën", fliste si nëpër ëndërr.

Avioni "Turkish Airlines" sapo futej nëpër re, ngrihej mbi ato si të kishte frikë se mos verbohej. Atëherë ime shoqe, në krahun tim, pyeste se çfarë shikoja atje poshtë. "Male të bardhë me re", - i thashë. Pastaj ankohej se bordi i avionit i dukej burg i errët, nëpër të cilën dallonte vetëm një dritëz të zbehtë. Ish-te një televizor, me ekran të vogël të cilit shënohej data 20 Ekim 2009. Temperatura - 54.

"Gunajden" dëgjojmë ëmbëlsinë e zërit të një femre që na serviri drekën. Për mua nuk ishte hera e parë që udhëtoja me avion. Përpara viteve 90 isha kolovitur në shumë linja nëpër Jugosllavi, Çekosllavaki, Itali, Vjenë, Zivcër. Përshtypjet e atyre viteve në kujtesën time ishin bërë njësh: kontrolli në doganë, buzëqeshja e stjuardesave apo pasagjerë të përgjumur e të përhumbur, prej të cilëve përveç ftohtësisë, nuk ruaj asnjë mbresë, asgjë të ngjashme me ngrohtësinë që po përjetoja në "Turkish Airlines". Mbi të gjitha kujdesi për udhëtarët e sëmure këtu s'kishte të paguar dhe pagesa ishte brenda biletës. Nëse shkallët e avionit në Rinas e sëmura me një patericë dhe shikimhumbur i ngjiti e do t'i zbriste për tmerr, në aeroportin e Stambollit u ngjit ashensori te dera e avionit. Dhe kur futemi në ambientet e brendshme pafund "O Zot, çfarë kujdesi!"

Një punonjës me emrin Sihati na pret gjithë mirësjellje me mjetin transportues. Është ai që bën veprimet tona. Te sporteli i vizave zgjasim dy pasaportat dhe dyfishin e pagesës, 40 euro. Zonja që firmos dhe vulos, duke kthyer gjysmën e shumës, përdor me elegancë fjalën "Tamam, tamam".

Në respekt të shërbimit që na afrojnë punonjësit turq seç na kap një përzjerje malli. Kur turku Sihati merr edhe bagazhin tonë, me zor pranon 5 euro bakshish "Hallall, hallall", na uron. "Hallall", ia kthejmë edhe ne si ta surprizojmë se shumë turqizma sikur të jenë ushtarët të mbajtur peng qysh në betejën e Domosdovës, vazhdojmë t'i ruajmë në fjalorin e gjuhës shqipe, si urë lidhëse në epokën e re. Dhe i buzëqeshim njëritjetrit sikur të promovojmë paqen e vërtetë.

Ndërgjegjia që rri zgjuar

Kur dolëm prej aeroportit kishte rënë nata. Pritëm vetëm një çast, si besimtari që pret shpëtimtarin të zbresë prej qiellit. Brenda atij çasti dëgjuam zërin e Dr.Kastriotit të na fliste hajdeni me mua. Ky është njeriu ynë, i cili tre ditët e javës punon në Klinikën e syve evropiane Tiranë, tre ditët e tjera ia shohin hairin pacientët turq në Stamboll. Në të moshës së tretë turq, si unë me bashkëshorten, gjallë në botë nuk do të ishim nisur për transplant nëse nuk do të na mundësonte Dr.Kastrioti. Ai e

MBRESA nga STAMBOLLI

Nga Haki BALLIU



trajtoi Fitneten për 7 muaj, shpesh me ilaçe dhe vizita falas. Kur shikimi i pacientes së tij perëndonte, na rekomandoi transplantim në Turqi. Ne refuzuam. Nisja për larg na dukej një aventura pleqsh. Nuk kishim as mundësi fizike, as finaciare dhe as shpresë. Vendosëm të pajtoheshim me fatin. Të njëjtat këshilla morëm nga okulistët e tjerë dhe të afërmit tanë. Po Dr.Kastrioti këmbëngulte. "Unë jam mjek, tha, kam parimin tim të mos e braktis të sëmurin." Ai bëri hapin e fundit dhe aktin më të lartë human, duke marrë përsipër gjithë shpenzimet e operacionit prej mëse 4000 eurosh. Duket qartë se në shpirtin e tij rri zgjuar ndërgjegjja e mjekut që pacienti të mos i errësohen sytë dhe bota. Më në fund me veturën e tij na shpuri në spitalin "Turkish Cerahi Hastanesi".

Nata e Transplantit

Mjeku turk, kirurgu, okulist Haneb Çakir, një burrë me pak thinja i shkathët e mendje hollë, kreu vizitën në prani të Dr.Kastriotit. Në pamjen e të dyve nuk mund të dalloje asgjë përveçse vendimin që transplantit të kryhej sakaq. Gruaja ime, së cilës gjer atë çast i mungonte dita me diell dhe nata me hënë, hyri në sallën e operacionit me një qetësi të habitshme.

Në atë pritje ankthi, që zgjati gati

dy orë, unë qëndroja në dhomën e të sëmurës shumë komode e pajisur me televizor, banjë, dush, orë muri, krevat të dytë për shoqëruenin. Madje ushqimi ishte i pasur si në kampe pushimi. Po mua asgjë s'më hyn në sy. Unë burri i thjeshtë i kësaj bote, nëse kisha ndonjë vlerë njeriu, në ato çaste doja ti vlej nënës sa fëmijëve të mi. Prisja i ndezur për ujë, por emrin turqisht nuk ia dija. U kojtova se kisha me vete një kalendar xhepi. Për të shuar etjen ishin dashur vetëm dy shkronja "SU". Kryeinfermiera më tregoi enën prej xhami dhe më dha të pija me dorën e saj. Çdo infermiere e sanitare të emociononte me mënyrën shembullore të shërbimit dhe sjelljes. Të gjitha "Çok gjyzel". Me të sëmurët përdornin dy fjalë përshëndetëse: "Gunajdin" dhe "Elveda", pra "mirëdita" dhe "mirupafshim". Po para nën dorë asgjë. Hiçbir. Ndërsa për kurgun Çakir thuhet se është një nadir. Pra i rrallë, shkëlqen.

Teksa të mrekullon ndenja e nderimit për gjithçka gjen aty, kujtesa dëshpërohet duke kthyer nga ke ardhur. Është sakrificë e madhe të stërmundohesh të gjesh shembuj të tillë admirues në spitalet tona. Edhe në këtë prag festash një mikja jonë fatkeqe me gjirin e hequr në Greqi, është duke bërë rreze në onkologjikun shtetëror të Tiranës. Ras-

ti i saj të bën të dridhesh. Jo pse kanceri i tregon dhembët e vdekjes por se në çdo seancë i duhet ose të paguaj mjekun ose të pranojë t'i shkurohen ditët e jetës. Që mjekësia t'i marrë gjoba të sëmurit më një lehtësi si të krihet në pasqyrë, duket se kjo ndodh vetëm te ne. E nuk di pse ministrat tanë të shëndetësisë mbahen rëndë, rëndë në ekranet televizive. Ndoshta sepse mjekët e shndërruar në politikanë në këtë botë të lirë, nuk e ndiejnë dhimbjen në mishin e një të varfëri. E thënë shkurt, ndryshe nga ne Turqia ka shtet. Shteti ka rregull, ka tertip, siç i thonë ata. Dhe tertipin më së pari e prek në spitalin "Instambul Hastanesi". Në mëngjes herët kirurgu Çakik vjen i zgjidh syrin e fashuar pacientes së operuar ne mesnatë. "Doktor, shoh" dëgjohej nëpër dhomë klithma e saj e lumturuar. "Mashalla, mashalla", i buzëqesh ai. Njëherësh i afron një tjetër mundësi; Nëse Stambollin do që ta shohë me të dy sytë, hajde pas tre muajve të operojmë tjetrin!"

Muret që më kujtuan tim atë

Qytetin e 14 milionë banorëve edhe unë e sodita pak. Kur zumë vend në Hotel EBRU nga më të mirët me 20 euro nata, shfletova fjalorin e xhepit ku lexova mbi 100 fjalë turke, të cilat ne i kemi bërë tonat. Po shënoj vetëm nga një sipas radhitjes së alfabetit turk me 24 shkronja:

Adet, batiava, çyryk, derexhe, evlat, fiqir, gajret, gjynah, haber, isharet, jabanxhi, kabull, lazëm, millet, namus, padisha, razi, sevda, teklit, xhevap, zjaret etje.

Këto e dhjetëra të tjera fjalë të shqiptuara kështu, base duhen trajtuar me kujdes si "minoritet" turk në Shqipëri. Në Stamboll imazhi shqiptar nuk të përplasit në fytyrë si fryma e acartë evropiane. Kur u thua se jam arnaut apo arnavut siç shkruhet, ata gjallërohen si të të kenë mik të vjetër. Një mbas dola të pi një kafe, por mu desh të shëtis shumë. "Në Stamboll ka më pak kafe se sa ka Tirana farmaci", më tha studenti Arens nga Poliçani që na shoqëroi gjithë ato ditë.

Së fundi monumenti hijerëndë ish-in muret ndarëse që ruheshin të pa prekur që nga koha e rënies së Bizantit. Pale sa burra me veshje viganësh ishin vlarë e prerë mbi ata mure gjigante kur aq triumfalisht turqit mposhtën ushtrinë greke të Bizantit. Ndoshta mbi ata mure kishte provuar shpatën edhe im at' asqer i Sulltan Hamitit në luftërat Ruso-Turke apo Turko-Greke. Duhet të ketë luftuar me top im at, por unë sepse po e përfytyroja me shpatën dy presa në dorë, me parzmorë të rëndë në kokë, me qafore çeliku në grykë. Mbas shtatë viteve ai u kthye tmerrësisht serioz, i heshtur aq dhe i fortë. Kurrë nuk tregoi nëse kishte vlarë apo kishte falur. Unë ashtu e mbaj mend deri ditën e fundit të vitit 1943. Gjithashtu kujtohem se me vete kishte sjellë një cigarishte qelibari, një kuti duhani dhe ca fjalë turkçede.

Përsëri tek Dr.Kastrioti

Ditën e tretë të mjekimit Dr.Çakir, mbasi na uroi udhë të mbarë "Gule,gule", na kujtoi se pavarësisht nga kryerja me sukses e transplantit, shërimin e plotë të syrit do ta ndjek dr. Kastriot Boriçi. Ne vazhdojmë të shkojmë tek doktori ynë në rrugën "Medar Shtylla". Ditët e fundit ai është pajisur me aparaturën më moderne të kohës, së cilës s'mund t'i shpëtojë asnjë "armik" sado i fshehur në syrin e pacientit. Edhe personelin e ka zgjedhur me merak. Vetë ai tashmë është dielli i ri okulistikës shqiptare.



Njohuri për nënprefekturën e Pogradecit

Ndodhet në Qarkun e Korçës. Përfshin: Qytetin e Pogradec dhe 7 Komuna, Trebinjë, Çërravë, Dardhas, Velçan, Proptisht, Buçimas, Udënisht

POGRADECI

Numri i popullsisë: 37.010 banorë
Sipërfaqja: 2.5 km²
Vendndodhja: Në lindje të Shqipërisë
Dega Kryesore e ekonomisë: Turizmi, peshkimi, shërbimet, bujqësi
Biznese: 708

Ndodhet në juglindje të Shqipërisë, buzë Liqenit të Ohrit në Lartësinë 696 metra.

Në një kodër në veriperendim të qytetit, gërmimet arkeologjike kanë zbuluar një vendbanim të shekullit V-të p.e.r, të krahinës së Dasaretisë, ndofta e quajtur Enkelana, që më pas u shëndërrua në qytezë në gjysmën e dytë të shekullit të IV-të. Pas pushtimit romak qyteza e humbi rëndësinë. Në shekullin e IV-të u rimëkëmb si një vendbanim i fortifikuar ushtarak bujqësor, dhe vazhdoi si i tillë deri në shekullin VIII-të kur u rrënuar. Gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare u bë qendër e veprimtarisë atdhetare. Disa ditë pas shkollës së Korçës, edhe këtu u hap shkolla e parë shqipe. Është vendlindja e poetit të madh Lasgush poradeci dhe e shkrimtarit Mitrush Kuteli.

Qyteti i vendosur në buzë të Liqenit, me një mikroklimë të veçantë, me shumë gjelbërim dhe me shumë ambiente pushimi, Pogradeci është një nga vendet më të bukura për pushim gjatë verës. Ka një infrastrukturë të mjaftueshme që lidhet me Qarkun e Korçës, me Doganën e Qafë-Thanës dhe me gjithë komunat e rrethit Pogradec.

Sot ka 37.010 banorë dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 2,5 km katërore. Aty veprojnë dhe kanë aktivitete 708 biznese, nga të cilët 385 në fushën e tregëtisë, 50 të ndryshme, 118 në fushën e transportit dhe 53 ambulatorë. Ka 5 kopshte fëmijësh, 5 shkolla fillore, 5 shkolla 9-vjeçare dhe 4 shkolla të mesme.

KOMUNA TREBINJË

Komuna Trebinjë përfshin 15 fshatra:

Trebinjë, Çezmë e Madhe, Çezmë e Vogël, Hondisht, Selcë e Sipërme, Llëngë, Plenisht, Hosh-tecë, Zemcë, Potgozha, Malinë, Kalivaç, Pevelan, Dunicë, Guri i Bardhë.

Numri i popullsisë 5.125 banorë
Sipërfaqja 117.7 km katërore
Vendndodhja Në lindje të Shqipërisë
Dega Kryesore e ekonomisë Bujqësi, prodhim drithrash
Biznese 34

Komuna Trebinjë ndodhet në jugperendim të Pogradecit. Në afërsi të Trebinjës janë gjetur gjurmët e një vendbanimi ilir, ku janë gjetur fragmente qeramike. Drejtimi kryesor i ekonomisë ka qënë prodhimi i dritharave të bukës, frutikultura dhe rritja e bagëtive të imta. Sot komuna Trebinjë ka 5.125 banorë, përmblendh 15 fshatra që shtrihen në një sipërfaqe prej 117.7 kilometra katërore. Aty veprojnë 34 biznese, nga të cilët 17 në fushën e tregëtisë, 3 në atë të shërbimeve, 14 të transportit. Ka 4 kopshte fëmijësh, shkolla fillore cdo fshat, 7 shkolla 9 vjeçare dhe 1 shkollë të mesme.

KOMUNA ÇËRRAVË

Komuna Çërravë përfshin 11 fshatra:

Çërravë, Blacë, Bletas, Alarup, Pretushë, Grabovicë, Nizhavec, Kordas, Leshicë, Lumas, Qershizë.

Numri i popullsisë 9.670 banorë
Sipërfaqja 89.2 km katërore
Vendndodhja Në lindje të Shqipërisë
Dega Kryesore e ekonomisë Bujqësi, frutikulturë
Biznese 120

Komuna Çërravë ndodhet në jugperendim të Pogradecit, në rrugën Pogradec-Korçë. Sot komuna Çërravë ka një popullsi prej 9.670 banorësh, përmblendh 11 fshatra që shtrihen në një sipërfaqe prej 89.2 kilometra katërore. Drejtimi kryesor i ekonomisë ka qënë kryesisht prodhimi frutave dhe njihet për cilësinë dhe prodhimin e mollës. Aty sot numrohen 120 biznese, nga të cilët 29 në fushën e tregëtisë, 4 janë me karakter prodhues, 7 në fushën e shërbimeve, 27 të licensuara për veprimtari të ndryshme 13 në të transportit, 40 ambulatorë. Ka 9 kopshte fëmijësh, shkolla fillore 7 shkolla 9 vjeçare dhe 2 shkollë të mesme.



KOMUNA DARDHAS

Komuna Dardhas përfshin 9 fshatra: Dardhas, Stropçkë, Grunjas, Prenisht, Dardushë, Osnat, Lekas, Nicë, dhe Stërkanj.

Numri i popullsisë 4.111 banorë
Sipërfaqja 86.9 km katërore
Vendndodhja Në lindje të Shqipërisë
Dega Kryesore e ekonomisë Bujqësi, frutikulturë
Biznese 21

Komuna Dardhas ndodhet në perendim të Pogradecit. Banorët e kësaj komunë jënë përmendur për punimin e veglave bujqësore prej druri.

Sot komuna Dardhas ka një popullsi prej 4.111 banorësh, përmblendh 9 fshatra, dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 86.9 kilometra katërore. Drejtimi kryesor i ekonomisë ka qënë kryesisht prodhimi bujqësor. Aty sot veprojnë 21 biznese, nga të cilët 10 janë me karakter në fushën e tregëtisë. Ka 5 kopshte fëmijësh, 8 shkolla fillore dhe 5 shkolla 9 vjeçare.

KOMUNA VELÇAN

Komuna Velçan përfshin 8 fshatra: Velçan, Buzaishtë, Shpellë, Bishnicë, Jollë, Losnik, Laktesh, dhe Senisht.

Numri i popullsisë 5.016 banorë
Sipërfaqja 114.9 km katërore
Vendndodhja Në lindje të Shqipërisë
Dega Kryesore e ekonomisë Bujqësi, prodhim drithrash
Biznese 99

Komuna Velçan ndodhet në veriperendim të Pogradecit. Ka pasur drejtim kryesor prodhimin e drithrave të bukës dhe rritjen e bagëtive të imta.

Sot komuna Velçan ka një popullsi prej 5.016 banorësh, përmblendh 8 fshatra, dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 114.9 kilometra katërore. Aty sot veprojnë 99 biznese, nga të cilët 25 janë në fushën e transportit. Ka 2 kopshte fëmijësh, 8 shkolla fillore, 4 shkolla 9 vjeçare, dhe 1 shkollë të mesme.

KOMUNA PROPTISHT

Komuna Proptisht përfshin 15 fshatra: Proptisht, Rodokal Sipër, Rodokal Poshtë, Homesh, Slabinjë, Somotinë, Kriçkovë, Selcë e Poshtme, Homçan, Vërri, Golik, Slatinë, Baribardhë, Selishtë, Zalltorre.

Numri i popullsisë 8.218 banorë
Sipërfaqja 76.8 km katërore
Vendndodhja Në lindje të Shqipërisë
Dega Kryesore e ekonomisë Bujqësi, frutikulturë
Komuna Proptisht ndodhet në perendim të Pogradecit. Në fshatin Selcë e Poshtme zonë e kësaj Komune, në një kodër të fshatit është zbuluar një qytet ilir. Si vendbanim i lashtë është formuar në periudhën e hershme të bronzit dhe ka vazhduar pa ndërprerje në epokën e hekurit. Në shekullin VI-V-të p.e. u zhvillua si qendër proto urbane në rrugën natyrore të shkumbinit. Në shekullin IV-të u kthye në qytet të fortifikuar me mure gurësh të latuar në një sipërfaqe prej 3 hektarësh dhe me shtirje të lagjeve jashtë tyre

.Nga shekulli IV-I-rë p.e. shëndërrohet në një qendër të rëndësishme prodhimi, shkëmbimi dhe administrimi e krahinës ilire të Dasaretisë.

Komuna Proptisht ka një popullsi prej 8.218 banorësh, përmblendh 15 fshatra, dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 76.8 kilometra katërore. Drejtimi kryesor i ekonomisë ka qënë kryesisht prodhimi bujqësor e blektoral. Aty sot veprojnë 75 biznese, nga të cilët pjesa më e madhe janë në fushën e transportit dhe të tregëtisë. Ka 5 kopshte fëmijësh, 15 shkolla fillore 9 shkolla 9 vjeçare dhe 2 shkolla të mesme.

KOMUNA BUÇIMAS

Komuna Velçan përfshin 8 fshatra: Buçimas, Tushemisht, Peshkëpi, Gurras, Gështenjas, Remaj, Vërdovë, dhe Bahçellëk.

Numri i popullsisë 13.894 banorë
Sipërfaqja 58.8 km katërore
Vendndodhja Në lindje të Shqipërisë
Dega Kryesore e ekonomisë Bujqësi, e blektori

Komuna Buçimas ndodhet në juglindje të Pogradecit. Në kohën e pushtimit osman ishte qendër administrative. Emri i më parshëm ka qënë Starovëdhe në atë Tushemishtit, praën Liqenit të Pogradecit. Është dalluar për rritjen dhe mbarështrimin lopëve.

Sot komuna Buçimas ka një popullsi prej 13.894 banorësh, përmblendh 8 fshatra, dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 58.8 kilometra katërore. Aty sot veprojnë 40 biznese, në fusha të ndryshme sipas interesave të komunitetit dhe të peshkimit e në fushën e transportit. Ka 6 kopshte fëmijësh, 6 shkolla 9 vjeçare, dhe 1 shkollë të mesme.

KOMUNA UDËNISHT

Komuna Udënisht përfshin 6 fshatra: Udënisht, Mëmëlisht, Çervenakë, Piskupat, Lin dhe Buqezë.

Numri i popullsisë 6.460 banorë
Sipërfaqja 64.7 km katërore
Vendndodhja Në lindje të Shqipërisë
Dega Kryesore e ekonomisë Bujqësi, dhe blektori
Biznese 82

Komuna Udënisht ndodhet në perendim të Pogradecit, dhe në anën perendimore të liqenit të Ohrit. Ka pasur drejtim kryesor prodhimin e drithrave të bukës dhe rritjen e bagëtive të imta.

Sot komuna Udënisht ka një popullsi prej 6.460 banorësh, përmblendh 6 fshatra, dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 64.7 kilometra katërore. Aty sot veprojnë 82 biznese, nga të cilët 18 janë në fushën e tregëtisë, 3 janë me karakter prodhues, 7 në fushën e shërbimeve, 42 të licensuara për veprimtari të ndryshme, 9 në fushën e transportit, 3 ambulatorë. Ka 6 kopshte fëmijësh, 6 shkolla fillore, 6 shkolla 9 vjeçare, dhe 1 shkollë të mesme.

Të dhënat janë marrë nga Almanaku i bashkive dhe komunave të shqipërisë të botuar nga ministria e pushtetit vendor dhe dencentralizimit në vitin 2005

VAJZA DHE NIPI NGA PELIONI DREJTUAN EPIRIN PAS VDEKJES SË PIRROS

Nga Zenun FERO

Pirroja është një nga udhëheqësit më të mëdhenj të kohës së tij, lindi në vitin 319 para Krishtit. Të atin mbretin Ajakid e rrezoi nga fronin Kasandri. Në Epir u vendos Lysimaly, i cili ndoqi Olimbinë dhe e vrau në vitin 317 para Krishtit. Kishte 35 vjet që kishte drejtuar me mendjen e saj dy shtete më me zë të kohës, Mqedoninë dhe Epirin.

Një grup kalorësish, përkrahës të Ajakidit, dy prej tyre Angeli dhe Androkliidi, morën Pirron e vogël dy vjeçar të mbështjellë. Pas tre ditësh e dërguan në pallatin e mbretit të taulantëve, Glaukut. Të dy motrat e Pirros, Deidamea e Troa më e rritura nuk e kuptonin se ç'ndodhte.

Kasandri, dërgoi njerëzit për të marrë Pirron tek taulantët kundrejt një shpërblymje prej 200 tolente (një peshë jo moneshë, e barabartë me 26.2 kg argjend). Glauku u ktheu përgjigje, nuk e dorëzoi dhe do t'u shpallë luftë.

Pirroja ishte 10 vjeç po rritej me dejmte e Glaukut, dhe po stërvitej me shpatën e shkurtër iliria me shpejtësi, me harkun e vogël leshonte shigjeta drejt e në shenjë. Glauku, po merrte masa për të vendosur Pirron në fronin e Epirit.

Në pranverën e vitit 307 para Krishtit, ushtria e Glaukut u drejtua për në Jugë, dhe u prit

nga Angeli, i ngjante të atit Ajakidit. Por e luftuan Pirron, dhe Glauku e ftoi Pirron të qëndronte tek taulantët, sa të piqeshin kushtet.

Në vitin 296 para Krishtit në moshën 22 vjeçare merr kurorën e Epirit. Glauku dërgoi të birin, Manunin, nga enkelenasit dhe nga lynkeset shkoi Bardhyli i Ri, i afroji bashkëpunim. U bë pallati i Pirros me Ledhës, në vendin që kishte qënë.

Pirroja ishte martuar me Antigonen, ishte vajza e mbretëreshës Beronika, gruaja e Pletomeut kishte këtë vajzë me Filipin e Dytë, kur ishte gruaja e tij. Në vitin 295, pas një viti si mbret, lindi djalë e quajten Ptoleme, të bëhej si "babai" i Egjiptit. Pas vdekjes së Glaukut, Bradhyli i Ri i enkelenasve i kërkoi Piro, të vendoste Monunin në krye të taulantëve. Pirron në tokat e taulantëve e mirëpritën dhe portat ishin të hapura.

Në vitin 294 para Krishtit u nda nga jeta Antigona, gjatë lindjes së vajzës Neridës. Pas kësaj në vitin 292 para Krishtit Pirroja shkoi tek enkelenasit, në kryeqendrën e tyre në Pelion. Mbreti Bradhyli i Ri shtroi njëra pas tjetrës dreka dhe darka, për nder të Pirros, pas kësaj shkoj tek lynkestët. Pirroja aleati i tij sundon sigurtë në vendin e vet. Në fundin e verës në vitin 292 para Krishtit, në portat e Pelionit trokiti një suitë nga oborri i Epirit. Pirroja kërkonte për grua Brikenën, vajzën e mbretit të enkelenasve, Bardhyli të Ri. Pas



Brikenës grua mori Lamasën nga Siraguza, mori gruan tjetër, të tretë Olimbinë, vajza e Audeolonit, mbreti i paionëve.

Këto martesë realizonin të ardhmen e Epirit. Lindën fëmijët, Brikena lindi djalë që i vuri emrin Aleksandër, Lamasa lindi një vajzë Lisandra. Antigona i la dy fëmij, djalin Ptolemeun dhe vajzën Nereidës. Pirroja kishte pesë fëmijë.

Brikena e enkelenasve dinte të afronte sa më shumë. Magjia e saj kapërxente kufijtë e mbërrin tek i ati në Pelion. Ndërsa Pirroja ndiqte fluturimin e saj në oborrin e enkelenasve, ku qëndronte në çdo kohë një shpatë dhe një mburojë që rrinte e ngritur kundër maqedonasve. Secila nga grate donte

të kishte pushtet mbi burrin Pirro, jo si Antigona, Delikatesa dhe urtësia e Brikenës së enkelenasve e shpëlodhte Pirron më shumë se dy të tjerët.

Në vitin 285 para Krishtit u nda nga jeta Bardhyli i Ri, në dimër. Vdekja ishte e parakohëshme dhe e pa pritur kjo ngjalli hidhërim në gjithë oborrin e saj, epiriotëve e Brikenës. Pirroja bashkë me Brikenën, të shoqëruar nga një suitë e veshur me rroba të zeza, mbriti në Pelion, për ngushëllime, Monuni, Andoleoni e shumë të tjerë sundimtarë të tjerë fqinjë, kishin mbërritur më parë dhe ishin larguar në vendet e tyre. Pas shumë lufrash, në vjesh-tën e vitit 272 para Krishtit në fushatën para Argosit, u nda

nga jeta Pirro në moshën 47 vjeçare, pas një sundimi mbretëror të pa shkëputur prej 25 vjetësh. Pasa vdekjes së Pirros, në krye të Epirit erdhi djali i tij Aleksandri, djali i Brikenës. Atij i'u imponua një luftë e rrezikshme nga mbreti i ilirëve Mytilli, të cilin me vësh-tërsi mundi të përballej. Mbreti maqedonas Demetri II, e detyroi atë të heqë dorë jo vetëm nga Maqedonia, por për një kohë edhe nga Epiri, mbi të cilin vendosi kontrollin e tij. Aleksandri kthehet në fron me ndihmen e tolëve. Ai përpoq të kthejë fuqinë e deridikushme, por nuk arriti qëllimet, drejtoi 32 vjet, deri 240 para Krishtit. Pas këtij fronin e merr mbretëresha e fundit epiriothe, Deidama, e cila vritet nga populli në vitin 234 para Krishtit. Shteti epiriot reformohet në një formë të re, me karakter republikan, që u quajt Lidhja Epiriothe 234-168 para Krishtit, u shpall republike, u shemb monarkia.

Në vitin 167 para Krishtit ushtria e Romës, me Konsullin Emil Pauli, shkatërroi krahinat e mollosëve dhe fiseve të tjera duke djegur 70 qytete dhe skllavëruar me shume se 150 000 epiriotë. Epiri u fut në vartësi të Romës.

Për fatin e Brikenës dhe djalit të saj mbretit të Aleksandri literature nuk jep të dhëna të plota. Ai drejtoi Epirin për 32 vjet, një nip nga Pelioni, nga Mokra. Brikena, e bija e Pelionit tregoi aftësitë e saj si mbretëreshë.

Nga Zabit CUKU

DERI KU SHTRIHET TOSKËRIA

Toskëria është një emërtim i përgjithshëm për krahinat etnografike të Shqipërisë jugore që shtrihet nga lumi shkumbin deri në gjirin e Artës në Jug dhe nga vargu i maleve Gramoz në lindje deri në brigjet e detit Adriatik e Jon në Perendim.

Dëshmohet për të parën herë në dokumentet historike të shekullit XV-të. Emri "Toskëri" mendohet se vjen nga mbiemri i një fisi më të hershëm, që banonte në mallet mes rrjedhjes së sipërme të lumenjëve Devoll e Vjosë. Gjatë shekujve XV dhe XVII, ky fis bashkoi rreth vetes disa grupime të popullsisë rreth tij, si Dëshnica, Dangëllia, Shqeria, Opari, Skrapari, Vërça, Shpati, Mokra dhe me ta formoi një bashkësi ekonomiko-shoqërore që ishte bërthama e Toskërisë së ardhshme.

Gjatë shekullit XVII pati lëvizje të shumta të popullsisë. Grupe toskësh nga bërthama e lartpërmendur kaluan Vjosën dhe u vendosën në Labëri, dhe anasjelltas, grupe labësh u vendosën në Toskëri, veçanërisht në Tomoricë, Skrapar e Kolonjë. Labë e toskë, gjithashtu, në

LIDHJET E MOKRËS ME TOSKËRINË E GEGËRINË

këtë kohë u vendosën në Myzeqe.

Nga fundi i shekullit XVIII, rreth pashallëkut të Janinës së Ali Pashë Tepelenës u bë përqendrimi i Shqipërisë së Jugut në një njësi të vetme politko-ekonomiko-shoqërore. Morën pjesë Myzeqeja, Labëria, Çamëria dhe Toskëria. Kjo e fundit i dha emrin gjithë njësisë së re. Me kalimin e dekadave, dhe me hovin e Rilindjes Kombëtare në shekullin e XIX, Toskëria dhe dallimi i saj nga Gegëria e humbi rëndësinë. Sot emri Toskëri ka mbetur si nocion historiko-etnografik.

KUR ËSHTË PËRDORUR TERMI "GEGËRI"

Gegëria është sot një emërtim i përgjithshëm për krahinat etnografike të shqipërisë së Mesme e Veriore, duke nisur nga krahu i djathtë i lumit Sh-



kumbin. Por, kjo shtrirje e termit Gegëri i takon kohës së re. Sepse, Gegëria e mirëfilltë, e cila njihet dikur me emërtimin popullor 'Malet e Gegëve' përfshinte krahinat nga Shkumbini deri në lumenjtë e Ve-

leshicës, Lures, Urakës, e rrjedhjen e poshtme të Matit (në perendim shtrihet deri në bregdet dhe në lindje deri ku shtrihen historikisht shqiptarët).

Bashkësitë e vogla që morën të parat emrin "Nëntë Malet e Gegëve" qenë: Mati, Martaneshi, Lura, Dibra, Malësia e Tiranës dhe e Krudës, Benda, Tomadheja, Kurbin, Fusha e Arbërit, Çermenika.

Ky bashkim malesh gjeti shprehje më konkrete në mesjetë, në principatën e Kastriotëve. Me pushtimin osman, krahinat e vogla që bënin pjesë në gji të saj, nuk mundën ta ruanin më njësinë e mëparëshme.

NJË KUPTIM KANË KATUNDI EDHE FSHATI ?

Termit "katund" (në fakt saktësisht shkruhet "katun") dhe "fshat" kanë pasur kuptime të ndryshme. Banorët e Katu-

nit në zanafillë janë marrë me blektori dhe kanë pasur organizim shoqror të ndryshëm nga Fshati, i cili historikisht ushtronte kryesisht bujqësinë.

Në shoqërinë feudale kahunarët dalloheshin prej fshatarëve nga pozita social ekonomike (ishin më të kamur) dhe paguanin detyrime të ndryshme. Banorët e Katuneve shpeshëtonin me bagëtitë sipas stinëve në kullota veriore ose dimërore dhe pjestarët e familjeve të tyre "ndareshin" mes këtyre dy vendbanimeve që përgjithsisht merrnin emrat e krerëve të vllazërive.

Në shekullin XV kishte katune vetëm në një trevë të ngushtë malore të sanxhakut të Shkodrës, kryesisht në viset e Kuçit, Kelmendit dhe Pipërit, si p.sh., katuni i Bushatëve, Reçëve, Bukëmirëve, Kuçëve, Bankeqëve, Lazorçëve, Loparëve, Bankeqëve, Gjonajve, Lleshajve, Muriqëve dhe Kolemadhëve.

Viset e tjera malore të Shqipërisë Veriut dhe trevat e tjera shqiptare kishin fshatra bujqësore ose blektorale të formuara shumë kohë para pushtimit osman. Pas shekullit të XVI, procesi i shëndërrimit të katuneve në fshat përfundoi dhe pas kësaj periudhe fjala Katun behet sinonim me fjalën Fshat.

Gjurmë dhe gjurmime

Transporti tokësor shqiptar nga Lufta e Parë në Luftën e Dytë Botërore (1914 – 1939)

Nga Llazi TONA

Vijon nga nr i mëparshëm

Më 1914-1918 Shqipëria u bë shesh lufte dhe u pushtua nga fuqi të ndryshme ndër-luftuese si Austrohungaria, Italia, Franca, Bullgaria, Serbia dhe Greqia. Shqipëria ishte një vend gati pa rrugë, gjë që ishte pengesë e madhe për lëvizjet e ushtrive pushtuese. Prandaj të tri fuqitë e mëdha të Europës, që në fillim të pushtimeve të tyre, u kujdesën për ndërtimin e rrugëve. Ndërtimi i këtyre rrugëve i shërbeu edhe dhe popullit tonë duke lehtësuar këmbimet midis zonave të nfryshme të vendit.

Ushtria austro-hungareze ndërtoi këto rrugë:

1- Rruge per automjete: Shkodër-Vlorë; Tërbuf-Lushnje; Shkodër-Shirokë; Shkodër-Durrës; Shkodër-Hani i Notit; Tiranë-Durrës; Durrës-Kavajë; Lushnjë – Berat.

2- Përmirësoi dhe zgjeroi rrugë karvanesh: Shkodër-Vau i Dejës; Dejë-Pukë; Milot-Burgajet; Tiranë-Qafë Shtamë-Elbasan; Kukës-Prizren.

Kur u terhoq më 1918 ushtria austro-hungareze përfundoi 850 km rrugë për automjete dhe 450 km rrugë dekovili.

Ushtria italiane ndërtoi gjatë luftës së parë botërore këto rrugë:

1- Për automjete: Vlorë-Tepelenë-Gjirokastrë; Vlorë-Llogara-Gjirokastrë; Vlorë-Llogara-Himarë-Sarandë; Vlorë-Mifol-Vjosë; Sarandë-Delvinë-Jergucat-Gjirokastrë.

2- Rrugë pa riparim: Tepelenë-Këlcyrë-Ballaban

3- Dekovile: Vlorë-Goricë-Panaja; Vlorë-Tepelenë-Bestrovë; Vlorë-Qafa e Koçit-Shushicë.

4- Teleferik: 15 copë të vegjël që plotsonin nevojat e transportit.

Ushtria franceze gjatë periudhës 1914-1918 ndërtoi këto rrugë:

Për automjete: Zvezdë-Grabovicë; Bilisht-Korçë; Korçë-Voskopojë; Korçë-Pogradec; Pogradec-Alarup-Peshkëpi.

Filloi rruga Pogradec-Niçë-Varrë i plakës por nuk e ndërtoi, një pjesë e la si trase.

Automjetet e para në Shqipëri erdhën më 1914 me ndërtimin e rrugëve.

Qeveria e dalë nga Kongresi i Luishnjës më 1920 që ishte vendosur në Tiranë krijoi Drejtorinë e Përgjithshme Botore. Që në fillim u muarr me meremetimin e rrugëve dhe urave. Në fund të vitit 1920 kjo drejtori nëpërmjet qendrave të Prefekturave si në Korçë, Elbasan, Vlorë etj dërgon kuadrot e para të transportit automobilistik; inxhinierë për mirëmbajtjen e rrugëve. Më 1921 Drejtoria Botore u shndërrua në Ministrinë e Punëve Botore që do të merrej me projektme për ndërtim, riparim dhe mirëmbajtje të rrugëve dhe urave. Për tu bërë ballë mungesave të teknikëve, u mundësua sjellja e një shumice inxhinierësh të tjerë nga Austria.

U ngrit nga Ministria e Punëve Botore një garazh i pajisur me ca makineri si: një torno, një trapan dhe një grup elektrik, ku punonin gjithësej 8 veta nga të cilët tre të huaj.

Qeveria e Sukejman Delvinës përpiloi dhe miratoi dhe ligjin rrugor që

ne sot e quajmë kodi rrugor. Ligji ishte me mjaft mungesa. Ai bazohej në ligjet turke për punë angari.

Sipas ligjit çdo nënështetas mashkull 18-56 vjeç ishte i detyruar të punonte 10 ditë në vit me pagesë për ndërtimin e rrugëve. Ata që nuk donin të punonin mund ta shlyenin detyrimin e tyre. Megjithatë sipas këtij ligji u ndërtuan një varg rrugësh dhe urash dhe u ndërtuan disa rrugë të tjera. U ndërtuan rrugët në Elbasan 37 km, rruga Pogradec-Qafa e Thanës dhe pjesët e rrugës Elbasan-Qukës.

Më 1922 u krijua nga MPB batalionet e rrugëve. Ky ka qenë një nga organizimet e mirëmbajtjes së rrugëve dhe urave. Këta batalione u inkuadruan në një formacion ushtarak me 800 punëtorë. Për punime arti u krijuan dy kompani mjeshtrash. Me krijimin e këtyre batalioneve u ndërtua një rrjet rrugor mjaft i rëndësishëm. Shumë qytete të rëndësishme u lidhën me rrugë transporti automobilistik. Në gusht të vitit 1926 Qeveria e Ahmet Zogut hapi trafikun me automjete midis Tiranës dhe Korçës. Ky trafik u konsiderua i rëndësishëm së veçantë. Kjo rrugë solli ndryshime të mëdha në marrëdhënie midis krahinave të ndryshme. Para ndërtimit të saj gati e gjithë tregtia e qarkut të Korçës bëhej me Manastirin dhe më vonë me Selanikun, duke përdorur hekurudhën që vinte gjer në Follorinë. Tani Korça u lidh me Durrësin ku shkonin prodhimet e saj dhe nga importoheshin mallrat europiane.

Sipas burimeve arkivore transporti automobilistik në Shqipëri, sasia e automjeteve sipas Prefekturave dhe N/prefekturave më 1927 ishte si më poshtë:

Prefektura	Sasia e automjeteve	N/prefektura	Sasia e automjeteve
Korçë	156	Pogradeci	12
Berati	30	Leskoviku	6
Fieri	26	Lushnja	18
Durrësi	68	Shijaku	10
Elbasani	34	Kavaja	40
Shkodra	86	Kruja	22
Tirane	140	Peqini	16
Vlora	37	Malësia e Madhe	4
Gjirokastra	69	Lezha	4
		Himara	12
		Përmeti	51
		Delvina	105
		Libohova	8



Më 1925 deri 1930 u ngritën disa shoqëri private të transportit automobilistik si shoqëria "Vjosa", "Shkumbini": Korça, "Morava", "Zëmlaku", "Tirana", "Elbasani" etj.

Në vitin 1926 deri 1930 u inportuan dhe disa automjete për transport të cilat sollën si pasojë ngritjen e diasë garazheve me bazë materiale ku kryheshin riparime të lehta dhe shërbime teknike të automjeteve.

Në prag të pushtimit fashist në Shqipëri ishin afro 300 kamjonë për transport 2 deri 3 ton, afro 20 autobuzë dhe rreth 200 vetura dhe kamjonçina.

Pushtuesi fashiste i kushtuan një vemendje të veçantë probleme ushtarke gjatë okupacionit. Në këtë kohë vrejtmë të bëhet punë e madhe në drejtim të rindërtimit të rrugëve ekzistuese dhe zgjerimit të mëtejshëm të rrjetit rrugor për nevoja strategjike.

Po kështu filloi sjellja në Shqipëri të një numri relativisht të madh automjetesh ushtarake. Krahas kësaj kemi një rritje të mjeteve të transportit të mallrave dhe udhëtarëve. Shoqëritë italiane për të zgjerur veprimtarinë e tyre sollën dhe një sasi automjetesh duke krijuar kështu Shoqërinë S.A.T.A. Vetëm për linjën Tiranë-Durrës një grup tregtarësh italianë sollën 14 autobuzë të markave Isoto Freskini dhe krijuan shoqërinë C.I.D.A.

(vijon në numrin tjetër)





**NONDA BULKA I'A ÇMONTE
LART VLERAT MITRUSH
KUTELIT, SI SOLIST I
LETËRSISË SHQIPE**

Mitrushi, që ishte i ndërgjegjshëm për vlerat e tij si shkrimtar, në këtë rast ndjente se koha që jetonte nuk ia njihte dhe çmonte. Ai ishte thuajse i harruar dhe krejt i mënjeluar. Bile jo shumë kohë më parë, redaksia e prozës Shtëpisë Botuese me pa të drejtë ia kishte kthyer dorëshkrimin me tregime për ta ripunuar. Këtë refuzim ai e kish përjetuar keq edhe një herë, pas kaq vitesh që kish tentuar të nxirte në dritë disa nga rrëfenjat e tij të hershme, nuk kish gjetur miratim. Ngushëllimin do ta gjente në shoqërinë e tij me Sterjon dhe Nondën, duke zbarzur mllëfin që kish brenda vetes. Dhe ata i qëndronin pranë, aq sa një ditë dy miqt' e tij të ngushtë i propozuan që të bënin një eskursion nëpër Myzeqe. Për këtë i ndihmoi Nuçi Tira Kryetari i Degës së Brendshme të Lushnjës, pogradecar, partizan i vjetër dhe adhures i shkrimeve të Mitrushit. Ai i shoqëroi me makinën e tij. U nisën me qejf dhe u kthyen plot mbresa nga takime dhe vizitat. Nonda me shakatë e veta e kishte bërë më të bukur udhëtimin. Përshtypjet e tyre të përbashkëta do t'i hidhte në një reportazh të gjatë Mitrushi. Ai u botua në revistën "nëntori" nën titullin "Fluturimthi nëpër një cep të Myzeqesë" dhe u nënshkrua nga të tre. Ishtë hera e parë që emir i mitrushit dilte në shtyp, jo si përkthyes, por si shkrimtar, gjë që do ta lehtësonte dikush atë shpirtërisht. Nonda do të më thoshte se honorarin, kur e morën nuk e ndanë por ja dhanë të gjithë Mitrushit. Natyrisht kjo nuk ishte aq e rëndësishme se sa fakti që, dalja publike e tij, i dha zemër miukut të tyre, i riktheu disi besimin e humbur dhe e inkurajoi t'i kthehet seriozisht punës krijuese. Nonda këtë e kish merak e peng të madh, sepse i'a njihte e çmonte lart vlerat si solist i letërsisë shqipe e jo si korist, ku e fuste ai veten dhe shumë të tjerë.

Nasho JORGAQI

Një piedestal për trevën e Mokrës dhe më gjërë

SHËNIME PËR LIBRIN E HAKI BALLIUT "RËNIA E PELIONIT"

Nga Bashkim BUSHI

Jam mësues në shkollën e mesme në fshatin Kotodesh, Librazhd. Autori Haki Balliu i librit "Rënia e Pelionit" novela e tregime, botuar nga shoqata "Pelioni" në dhjetor 2008, Tiranë, i dhuroi shkollave te mesme të zonës disa libra. Neve u gëzuam kur i pamë se këto lloj librash në zonat tona janë të rralla. Kur del një libër është si një foshnje dhe është krejt normale që për një foshnje të mos shprehish shumë konsiderata, në krahasim me një të rritur. Edhe unë nuk mund të rrinja pa shprehur konsideratat e mia. Libri kap një epokë të lavdishme të zonës së Mokrës. Pelioni (qytet) radhitet i dyti pas Antipatarea (Beratit). Ai përmendet nga Rufi dhe Ariani në pushtimin e betejës midis Klitit dhe Aleksandrit, dhe konsiderohet si qyteti më i fortë në vendin e dasaretëve. Pelionin deshën ta bëjnë "pronë", të tjerët por, arkeologu Neritan Ceka e lokalizon Pelionin në qytet ilir të Selcës së Poshtme, në krahinën e Mokrës. (Neritan Ceka "Qyteti Ilir pranë Selcës së Poshtme,, Tiranë 1985, faqe 152). Gërmimet kanë treguar se Selca e Poshtme, eskziston te si qytet që në mesin e shekullit IV-të para Krishtit, duke u mbështetur mbi një bazë protourbane.

Autori qytetin tonë Pelion e mbron, i nxjerr vlerat kulturore, historike, ekonomike, luftarake që ka pasur në dy librat e tij. Librin "Brikena e Pelionit,, Tiranë, 2004 dhe "Rënia e Pelionit" novela e tregime, në dhjetor 2008, Tiranë, përballë këtyre dy librave



çdo abuzues për "Pelionin,, thyen kokën. Autori tek libri "Brikena e Pelionit,, përshkruan shumë interesante, ngjarjet në Pelion, mbretin Bardhyl i Ri vajzën e tij Brikenën, Piron dymbëdhjetëvjeçar, Aleksandrin e madh e pa vetëm të vogël në Pelion. Pelioni kishte pritur strategët më të mëdhenj të botës, Aleksandrin e Madh dhe Piron e Epirit. Të dy ishin kushërinj. Të dy ishin pritur siç kishin ardhur. Aleksandri është pritur me luftë Pirua si dhëndërr. (Haki Balliu "Brikena e Pelionit" Tiranë, 2004 faqe 25).


Libri i dytë i autorit Haki Balliu "Rënia e Pelionit" Tiranë, 2008 pasqy-

Libri "Rënia e Pelionit" u kujton brezave që jetojnë dhe atyre që do të vijnë, se kush jemi, ku shkojmë. Ata njerëz, që i japin kohës emër, jetojnë më gjatë në memorien popullore, i tillë është dhe Haki Balliu. Burrat e mirë janë këtu, midis nesh.

ron në mënyrën artistike qëndresën e Pelionit, e quan "Zemra e Qëndresës". Armiqtë e Pelionit i shtuan, por ai qëndroi gjatë 1000 vjet, por rëndësia e tij historike sa vjen dhe shtohet edhe në ditët tona. Atë e mbrojtën djemtë e Pelionit, të drejtuar nga Belirani, Taurin dhe Yllko, që përbënin Këshillin e Luftës.

Libri "Rënia e Pelionit" u kujton brezave që jetojnë dhe atyre që do të vijnë, se kush jemi, ku shkojmë. Ata njerëz, që i japin kohës emër, jetojnë më gjatë në memorien popullore, i tillë është dhe Haki Balliu. Burrat e mirë janë këtu, midis nesh. Një fjalë e urtë thotë: "Guximi i madh zevendëson dijen e madhe" Hakiu uxoi, dhe deri tani shkroi dy libra, presim të tjerë. Vlerat e këtij libri nuk janë vetëm për trevën e Mokrës por edhe më gjërë.

Libri juaj ze një vend të veçantë në bibliotekat e shkollave tona, ky kërkon një studim e diskutim aq edhe të veçantë. Me këtë rast unë ju uroi për librat që keni shkruar. Ju fotj për vizitë në shkollën e mesme Kotodesh në një rast të mundshëm tuaj.



Hasan Çapari: "Peisazh nga Mokra"

Redaksia e gazetës "Mokra" dhe kryesia e shoqatës "Pelioni" urojnë të gjithë mokrarët, kudo ndodhen, "Gëzuar Vitin e Ri 2010!"